



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 61014-00656-00-2023 Regj. Themeltar
Nr. 00-2023-1810 i Vendimit**

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

**Illir PANDA -Kryesues
Sokol BINAJ -Anëtar
Sandër SIMONI -Anëtar**

Sot, më datë 07.11.2023, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale me nr. 61014-00656-00-2023 akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Shkallës së parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës

ME OBJEKT: Mosmarrëveshje kompetence.

BAZA LIGJORE: Nenet 83 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Në çështjen me:

KËRKUES: Dhionisios Alfred Beleri

Palë e interesuar: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Durrës

OBJEKTI: Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizim të veçantë.

BAZA LIGJORE: Nenet 8, 73, të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Sokol Binaj dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I. Rrethanat e çështjes,

1. Sipas evidentimit të bërë nga gjykatat në mosmarrëveshje, rezulton se kërkuesi/ankuesi, i pandehuri, Dhionisios Alfred Beleri, i është drejtuar me kërkesën/ankim Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me objekt: “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje autorizimi të veçantë”, duke thirrur në gjykim në cilësinë e palëve të interesuara Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës.

2. Referuar përmbajtjes së kësaj kërkesë, nga ana e kërkuesit/ankuesit parashtrohet se:

“Kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri aktualisht është i paraburgosur me vendimin nr. 46, datë 22.05.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, miratuar me vendimin nr. 19, datë 01.06.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Sipas vendimit nr. 611, datë 25.05.2023, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, shtetasi Dhionisios Alfred Beleri, është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Himarë në zgjedhjet vendore të datës 14.05.2023. Me vendimin nr. 418, datë 13.06.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është verifikuar mandati i kërkuesit, si Kryetar i Bashkisë Himarë.

Me qëllim marrjen e detyrës së Kryetarit të Bashkisë, të fituar si më lart, ankuesi duhet të kryejë betimin e tij para Këshillit të Bashkisë Himarë.

Bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020, kërkuesi gëzon të gjitha të drejtat të cilat nuk i janë kufizuar me vendimin me të cilin është caktuar masa e sigurimit “Arrest në burg”, ndaj tij dhe, referuar vendimeve gjyqësore të cituara më lart nuk rezulton që ndaj kërkuesit të jetë marrë masë sigurimi ndaluese, apo t’i jetë ndaluar e drejta për t’u zgjedhur. Gjithashtu, nga organet e ngarkuara me ligj, KQZ, Gjykata si dhe Këshilli i Bashkisë Himarë, sipas nenit 60 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, pas verifikimit të kushteve të zgjedhjes dhe mandatit, ka rezultuar shpallja e vlefshmërisë së mandatit të tij si Kryetar i Bashkisë Himarë.

Me qëllim kryerjen e betimit dhe marrjen zyrtarisht të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, ankuesi i është drejtuar me shkresë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale 313 Tiranë, për një mbledhje të Këshillit Bashkiak - të caktuar për në datën 27.06.2023. Përgjigja për këtë kërkesë ka ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, e cila e ka refuzuar kërkesën. Refuzimi i kërkesës i është njoftuar ankuesit, pasi kishte kaluar afati i mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, duke e bërë pa objekt ankimin e mundshëm në gjykatë kundër refuzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në njëjtën kohë ankuesi, për shkak të kohës së shkurtër të njoftimit për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Himarë, i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me vendimin nr. 266, datë 26.06.2023, është shprehur se nuk ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e kërkesës, pasi institucioni përgjegjës ishte drejtuesi i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku ndodhej kërkuesi.

Ankuesi i është drejtuar me kërkesë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Himarë të caktuar në datën 28.07.2023, kërkesë e cila është refuzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Edhe në lidhje me

këtë refuzim ankuesi nuk mund t'i drejtohej gjykatës, duke qenë se refuzimi i është njoftuar pas zhvillimit të mbledhjes dhe kërkesa kishte mbetur pa objekt.

Ankuesi ka paraqitur kërkesë për dhënien e lejes/autorizimi të veçantë, më datë 24.08.2023, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kërkesë e cila ka mbetur pa përgjigje.

Ankuesi ka paraqitur kërkesë për dhënien e lejes/autorizimit të veçantë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve më datë 06.09.2023, me qëllim që pas shqyrtimit të kërkesës të kërkojë të caktohet një datë për zhvillimin e ceremonisë së betimit në Këshillin e Bashkisë Himarë. Ankuesi ka parashtruar se ligji për të drejtat e të paraburgosurve ka patur të njëjtat parashikime në lidhje me lejen e veçantë, pavarësisht ndryshimeve të ligjit në periudha të ndryshme kohore, megjithatë interpretimi që i është bërë rasteve për dhënien e lejes së veçantë ka qenë i ndryshëm për kërkuar që kanë qenë mbështetës të pozitës, dhe i ndryshëm në rastin e tij. Kështu ankuesi ka parashtruar se të paktën në dy raste të njohura publikisht, praktika e ish-deputetit Azgan Haklaj dhe e ish-deputetit Mark Frroku, palët e thirrura në këtë gjykim, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi të saj, kanë pranuar kërkesat e kërkuarve dhe kanë dhënë “Autorizim për leje të veçantë për të marrë pjesë në seancë parlamentare. Konkretisht, ish-deputeti Azgan Haklaj është lejuar të betohet si deputet, pavarësisht se ka qenë me masën e sigurimit “Arrest në burg”.

Me shkresën nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, ka kthyer përgjigje në emër të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, ku ndodhet aktualisht kërkuar, duke rrëzuar kërkesën e kërkuarit.

Shkaqet e parashtruara në refuzimin për dhënien e lejes janë të pabazuara në ligj dhe në prova, pasi vendimi gjyqësor të cilit i referohet Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka refuzuar kërkesën e kërkuarit, por nuk e ka shqyrtuar atë, për shkak se kompetenca për shqyrtimin e saj i përket drejtuesit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale ku ndodhet kërkuar, dhe gjykata shqyrton ankimet kundër refuzimit, jo kërkesën. Bazuar në këtë vendim gjyqësor, ne i jemi drejtuar përsëri organit kompetent, dhe kundërshtojmë refuzimin e këtij institucioni si të pabazuar në ligj dhe në prova, pasi nuk ka asnjë vendim gjyqësor që të ketë shqyrtuar dhe rrëzuar kërkesën për dhënie autorizimi/leje të veçantë.

Bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” duke qenë se ankuesit nuk i janë kufizuar apo hequr të drejtat politike, kundërshtojmë refuzimin e kërkesës, aktin nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe kërkojmë pranimin e saj, si të bazuar në ligj dhe në prova.”.

2.1. Bashkëngjitur kërkesës, ankuesi krahas aktit të përfaqësimit, ka paraqitur Aktin nr. A-1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve. Referuar përmbajtjes së këtij akti (me lëndë “Kthim përgjigje”) rezulton se: “Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, është regjistruar me nr. 927, datë 06.09.2023, kërkesa e shtetasit Dhionisios Alfred Beleri, me masë sigurie “Arrest me burg”, e përcjellë me e-mail nga Drejtorja e IEVP Durrës. Nëpërmjet kërkesës evidentoni se, ... Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, ka shqyrtuar kërkesën për leje të veçantë të të burgosurit Dhionisios Alfred Beleri dhe konfirmon qëndrimin ligjor të shprehur me shkresë nr. 8295, datë 26.06.2023, refuzim i kërkesës, me baze ligjore neni 73 të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe që është trajtuar edhe në vendimin nr. 266, datë 26.06.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

2.2. Pavarësisht se në përmbajtje të ankimit/kërkesës (fq.3) referohet se bashkëngjitur kërkesës janë edhe këto akte: vendimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nr. 266, datë 26.06.2023; vendimi nr. 611, datë

25.05.2023 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; vendimi nr. 418, datë 13.06.2023, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Gjykata konstaton se këto akte nuk ndodhen bashkëlidhur kërkesës.

3. **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, me vendimin nr. 371, datë 18.9.2023, ka vendosur: “1. Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Tiranë, për gjykimin e çështjes penale me nr. 371 regj. themeltar, datë regjistrimi 15.09.2023, që i përket, ankues; Dhionisios Alfred Beleri. me objekt: “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë.”.

2. Dërgimin e çështjes dhe akteve bashkëlidhur pranë gjykatës kompetente në pikëpamjen lëndore dhe tokësore për gjykimin e saj, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

3. Kundër vendimit lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar në gjykatën kompetente.”.

4. Kjo gjykatë, ndër të tjera ka arsyetuar se, pika 2, e nenit 135 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton lëndën e gjykimit të gjykatave të posaçme. Kompetenca lëndore e gjykatave të posaçme në mënyrë të detajuar është përcaktuar në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ku listohen në mënyrë ezauruese veprat penale objekt gjykimi e këtyre gjykatave si dhe subjektet e posaçëm, që për shkak të funksionit të tyre në kohën e gjykimit, apo në kohën e kryerjes së veprave penale, përfshihen në lëndën e gjykimit të gjykatave të posaçme. Për vetë rëndësinë që pati ngritja dhe funksionimi i këtyre organeve të reja të drejtësisë, në kuadër të reformës së thellë të drejtësisë, ligjvënësi ka miratuar me shumicë të cilësuar edhe ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar.

5. Objekt i këtij ligji, ndër të tjera është edhe “Përcaktimi i kompetencave lëndore parësore dhe të tjera të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme. Në Kreun II, të titulluar “Kompetencat”, neni 8 titulluar “Kompetenca lëndore parësore”, parashikohet se: “1. Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohet në nenin 75/a të KPP, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës. 2. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo veprë penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji, ose nëse ai zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit.”. Ndërsa në nenin 9, titulluar “Kompetenca lëndore të tjera”, ky ligj parashikon se: “1. Gjykata kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo veprë penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji. 2. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale, sipas parashikimeve të nenit 8, të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë. 3. Prokuroria e Posaçme, në ushtrimin e ndjekjes penale sipas parashikimeve të nenit 8 të këtij ligji, ka kompetencë për të kërkuar zbatimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë. 4. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë kompetenca mbi hetimet, çështjet dhe kërkesat e paraqitura në përputhje me këtë nen.”.

6. Për të përcaktuar, kompetencat mbi hetimet, çështjet apo kërkesat e tjera të paraqitura në përputhje me këtë nen, i referohemi pikërisht nenit 13 të KPP, ku ligjvënësi duke përcaktuar edhe përbërjen e trupës gjyquese, në njëfarë mënyrë ka përcaktuar më në detaje lëndën që gjykojnë gjykatat e posaçme, duke përcaktuar në pikën 2, germa “F”, të tij se, “Gjykata Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon me një gjyqtar çdo kërkesë tjetër të parashikuar në këtë Kodi apo në ligje te veçanta.

7. Gjykata konstaton se kërkesa objekt gjykimi që i paraqitet për gjykim, në thelb përbën një kërkesë me natyrë administrative-penale, sepse me ane të saj kërkohet investimi i Gjykatës për të zgjidhur konfliktin e një të paraburgosuri me institucionin e ekzekutimit të vendimit penal ku ai po qëndron për efekt të masës së sigurimit personale shtrënguese “Arrest në burg”, i cili nuk lejohet të ushtrojë një nga të drejtat e tij politike.

8. Me qëllim garantimin e kësaj të fundit, por jo vetëm, ligjvënësi ynë ka miratuar ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i cili në nenin 1 të tij parashikon se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave dhe trajtimit të të paraburgosurve dhe të të dënuarve me burgim, organizimi i sistemit të burgjeve, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente”, ndërsa referuar nenit 2 ka për qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerezor, poshtërues apo degradues. Për zbatimin e këtij ligji është miratuar me VKM nr. 209, datë 06.04.2022, Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, objekt i së cilës ndër të tjera është edhe “respektimi i të drejtave themelore të të burgosurve”.

9. Ndërsa në ligjin e posaçëm nr. 81/2020 përcaktohen të drejtat dhe trajtimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, organizimi i sistemit të burgjeve, si dhe kompetencat e detyrat e organeve shtetërore kompetente, në pjesën e pestë, titulluar “Shqyrtimi gjyqësor i ankimeve dhe roli i Avokatit të Popullit”, neni 80 parashikon “gjykatën kompetente”. Referuar kësaj dispozite ligjore, kundër vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve mund të bëhet ankim në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e K.Pr.Penale.

10. Pra, nga ky parashikim ligjor, vetë ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë e të padyshimtë kompetencën lëndore dhe madje edhe tokësore të gjykatës kompetente që do gjykojë mbi ankimin ndaj vendimeve të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale ose të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, që është gjykata e vendit të ekzekutimit të vendimit penal. Duke qenë se ligji është i qartë në këtë pikë, rezulton e qartën se çështja në fjalë nuk është kompetence lëndore gjykimi e Gjykatës së Posaçme.

11. Ligjvënësi në fakt, në asnjë periudhë, qoftë edhe me ligjin e mëparshëm, për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, nuk i ka lidhur të drejtat e të burgosurve gjatë kohës që janë në institucionet e vuajtjes së dënimit me gjykatën që gjykon çështjen në themel pra, me gjykatën që po gjykon akuzën penale në ngarkim të të burgosurit.

12. Po të bëjmë një interpretim teologjik të kësaj dispozite ligjore, pra nenit 80 të ligjit nr. 81/2020, përcaktimi i qëllimit që ka pasur ligjvënësi për një parashikim të tillë ligjor, duke përcaktuar si gjykatë kompetente gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, lidhet me nevojën për të garantuar aksesin sa më të shpejtë dhe të lehtë të të burgosurit në gjykatë. Në asnjë rresht të legjislacionit në fjalë, nuk rezulton që ligjvënësi të ketë parashikuar se të drejtat e të burgosurit, kërkesat, mënyrat dhe procedura që duhet ndjekur, të bëhen pranë të njëjtës gjykatë që po gjykon akuzën penale në ngarkim të të burgosurit.

13. Nga një këndvështrim historik i legjislacionit rregullues në fjalë, Gjykata konstaton se edhe me ligjin e mëparshëm, atë me nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar (tashmë i

shfuqizuar), në nenin 71 të tij, të titulluar “Kompetencat e gjykatës”, parashikohet se: “Gjykata, në territorin e së cilës ndodhet institucioni, shqyrton me një gjyqtar të gjitha rastet që përcaktohen shprehimisht në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e të dënuarit, të cilat nuk janë zgjidhur nga institucioni mbi ankimin e të dënuarit me përjashtim të çështjeve për të cilat në Kodin e Procedurës Penale është përcaktuar kompetenca”, ndërsa në nenin 72 të tij, titulluar “Shqyrtimi i çështjes nga gjyqtari”, përcaktonte se: “Gjyqtari shqyrton çështjen dhe merr vendime vetëm përse është ankuar ose kërkuar në seancë gjyqësore me pjesëmarrje të detyrueshme të drejtorit të institucionit ose përfaqësuesit të tij. Kur çështja nuk mund të shqyrtohet pa praninë e të dënuarit, seanca zhvillohet në mjedise të përshtatshme të institucionit ku ndodhet. Në shqyrtimin e çështjes merr pjesë edhe avokati i kërkuar nga i dënuari ose i caktuar kryesisht për të dënuarit e mitur, ata që kanë shqetësime psikike, gratë me barrë ose fëmijë në gji, si dhe të dënuarit me shtetësi të huaj”.

14. Sa më sipër, duke qenë se kërkesa objekt gjykimi, nuk përfshihet në çështjet e rregulluara nga Kodi i Procedurës Penale, por nga ligji i posaçëm, ai me nr. 81/2020 dhe ky i fundit ka përcaktuar si gjykatë kompetente për çështjet që lidhen me të drejtat e të burgosurit, gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, atëherë Gjykata e Posaçme nuk është kompetente për gjykimin e çështjes objekt shqyrtimi. Gjithashtu, pavarësisht se vendimi që po ekzekutohet ndaj kërkuarit/ankuesit Dhionisios Alfred Beleri është një vendim i dhënë nga Gjykata e Posaçme (rivlerësuar masa e sigurimit) dhe urdhri i ekzekutimit është nxjerrë nga Prokuroria e Posaçme dhe vetë ligji për ekzekutimin e vendimeve penale parashikon që për kontrollin e ekzekutimit njoftohet edhe prokurori që ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, në asnjë rast çështja në lëndë të një prokurorie, nuk nënkupton automatikisht se bën kompetente edhe gjykatën pranë së cilës ajo prokurori ndodhet, por e kundërta po, një gjykatë kompetente bën për rrjedhojë edhe prokurorinë pranë saj kompetente. Kjo lidhet me parashikimin kushtetues se “Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj dhe se “Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.”.

15. Ligji i posaçëm, siç është ai me nr. 81/2020, vetëm në rastin e ankimit ndaj vendimit të ministrit të Drejtësisë për vendosjen ose zgjatjen e regjimit të posaçëm të të burgosurit, parashikon taksativisht si kompetente Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

16. Pasur në konsideratë se në vendimin e deklarimit të moskompetencës, Gjykata ka detyrimin të dërgojë edhe aktet pranë gjykatës kompetente në zbatim të nenit 85 të KPP, i referohemi nenit 80 të ligjit nr. 81/2020 që bën kompetente gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Referuar vetë përmbajtjes së kërkesës ankimore, nga ankuesi parashtrohet se ai aktualisht është duke qëndruar pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës, e për rrjedhojë çështja objekt gjykimi është kompetencë lëndore dhe tokësore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Pavarësisht se vendimi që ankimohet është ai i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe institucioni që ai drejton e ka selinë në Tiranë (me juridiksion në gjithë territorin shqiptar), vetë neni 80 i ligjit nr. 81/2020 parashikon qartë se, ndaj vendimit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale apo edhe të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ankimi bëhet në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal.

17. Thënë sa më lart, përfundimisht gjykata shpall moskompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për gjykimin e kërkesës penale nr. 371 regj. themeltar, datë regjistrimi 15.09.2023, që i përket, ankues: Dhionisios Alfred Beleri, me objekt: “Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., date 08.09 2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi te

veçante” dhe vendos dërgimin e akteve pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, si gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkesë penale.

18. **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**, me vendimin me nr. 137, datë 10.10.2023, ka vendosur:

“1. Të parashtrijë përpara Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore për gjykimin e kërkesës penale nr. 71029-02531-11-2023/561 regjistri themeltar, datë regjistrimi 22.09.2023, me objekt: Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar me datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/ autorizimi të veçantë.

2. Dërgimin e kopjes së akteve Gjykatës së Lartë.

3. Një kopje e vendimit do t'i dërgohet për njoftim Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”

19. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës çmon se vendimi nr. 371, datë 18.09.2023, “Për shpalljen e moskompetencës lëndore”, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është vendim i pabazuar në ligj. Përsa më lart, gjykata bazuar në kërkesat ligjore të neneve, 83-85, 89-90 të KPP, duhet t’i drejtohet Gjykatës së Lartë me vendim për, “Ngritjen parashtrimit e çështjes së mosmarrëveshjes për kompetencën lëndore”, për kërkesën penale nr. 71029-02531-11-2023/561 regjistri themeltar, datë regjistrimi 22.09.2023, me objekt: Kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar me datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë, duke argumentuar si më poshtë vijon:

20. Referuar parashikimeve të neneve 74 dhe 75/a të KPP, lidhur me kompetencën lëndore të gjykatave është bërë një ndarje e qartë. Në këtë mënyrë kompetenca lëndore penale e gjykatave të zakonshme përcaktohet me karakter mbetës, që do të thotë se çfarë veprash penale nuk parashikohen si kompetencë lëndore e posaçme e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është në kompetencën lëndore të gjykatave të zakonshme dhe me juridiksion të përgjithshëm.

21. Gjykata vëren se ligji nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”, në nenin 73 të tij, nën titullin “leje të veçanta”, parashikon shprehimisht se: *“1. I burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit. 2. Leja e veçantë për të dënuarin jepet nga drejtori i institucionit, ndërsa për të paraburgosurin jepet nga drejtori i institucionit me pëlqimin paraprak të prokurorit. 3. Leja e veçantë jepet për një kohëzgjatje deri në 48 orë. Leja e veçantë mund të zgjatet me kërkesë të të burgosurit edhe 24 orë të tjera vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, të cilat vërtetohen me dokumentacionin përkatës. Zgjatja e lejes miratohet në përputhje me pikën 2 të këtij neni. 4. Kundër vendimit të drejtorit të institucionit për refuzimin e lejes së veçantë mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e vendimit të refuzimit. 5. Vendimi për dhënien e lejes së veçante u njoftohet menjëherë strukturave të Policisë së Shtetit, të juridiksionit të vendit ku do të qëndrojë i burgosuri. 6. Rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesës për leje të veçantë dhe dokumentacioni shoqëruar përcaktohen në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.”*

22. Ky trup gjykues vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nuk ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e saj. Neni 278 i KPP, parashikon shprehimisht se: *“1. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”*

23. Neni 13 i KPP “Gjykatat penale të shkallës së parë dhe përbërja e tyre” parashikon shprehimisht se: *“1. Veprat penale gjykohen në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas*

rregullave dhe përgjegjësi të caktuara në këtë Kod. 2. Gjykatat e rretheve gjyqësore dhe Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykojnë me një gjyqtar: a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake; b) ankimi ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e ndjekjes penale apo pushimin e çështjes për kundërvajtjet penale; c) kërkesa e prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes për krimet; ç) kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq; d) kërkesën e prokurorit për miratimin e urdhrin penal; dh) kërkesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale; e) kërkesat për rivendosje në afat; ë) kërkesat që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, sipas titullit X të këtij Kodi; f) çdo kërkesë tjetër të parashikuar në këtë Kod apo në ligje të veçanta. 3. Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. 3/1. Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe. Kjo gjykatë gjykon me një gjyqtar akuzat penale kundër funksionarëve, sipas nenit 75/a, të këtij Kodi, për vepra penale të ndryshme nga korrupsioni dhe krimi i organizuar, për të cilat parashikohet dënim me gjobë ose me burgim në maksimum jo më shumë se 10 vjet. 4. Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse të krijuara sipas ligjit. Këto seksione gjykojnë edhe të pandehurit e rritur që akuzohen për kryerjen e veprave penale në dëm të të miturve. 5. Parashikimet e pikës 4, të këtij neni, nuk zbatohen në rastet e përcaktuara në paragrafin 1, të nenit 80, të këtij Kodi.”

24. Ndërkohë me paraqitjen e fazës së hetimit paraprak (i njëjti gjyqtar për të gjitha kërkesat e palëve), i humb kompetencat e tij, të cilat tashmë i kalojnë gjyqtarit të caktuar për shqyrtimin e kërkesës për gjykimin penal (gjyqtar i seancës paraprake). Një konkluzion të tillë gjykata e mbështet në interpretimin logjik dhe sistematik të nenit 278 të KPP në raport me nenet 13, 332 e vijues të KPP. Një konkluzion i tillë është arritur edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011.

25. Një nga këto raste, të parashikuara në ligj, është ankimi sipas nenit 73 të ligjit nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, gjendet në pamundësi juridike dhe praktike për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi. Neni 73, paragrafi 2, i ligjit nr. 81/2020, parashikon se për dhënien e “lejes së veçantë”, për të paraburgosurin jepet me pëlqimin paraprak të prokurorit. Kushtetuta në nenin 148, paragrafi 3, parashikon shprehimisht se: “Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.”. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nuk rezulton të ketë regjistruar asnjë procedim penal në ngarkim të kërkuesit Dhionisios Alfred Beleri, për këtë shkak ky subjekt është në pamundësi për të gjykuar nevojat e sigurimit, apo të mbajë një qëndrim për kërkesën e palës kërkuese.

26. Ky trup gjykues e vlerëson të gabuar interpretimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të bërë në kuadër të nenit 80 të ligjit nr. 81/2020. Gjykata e vendit të ekzekutimit, në kuptim të nenit 470 të KPP, është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Vendimet e formës së prerë janë vendimet e përcaktuara në nenin 462 të KPP.

27. Masat e sigurimit personal janë veprime procedurale të cilat heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit të proceduar, të parashikuara nga ligji për të parandaluar atë në kryerjen e veprimeve, që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, shmangien nga procedimi dhe veprimtaritë e mëtejshme kriminale, si dhe për të garantuar shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale. Zbatimi i masave të sigurimit personal rregullohet nga neni 246 i KPP dhe për çdo çështje që lidhet me zbatimin e tyre, kompetenca i takon

gjyqtarit të hetimit paraprak që i ka caktuar ato masa, në përputhje me nevojat e procedimit në funksion të të cilit ato janë.

28. Në mënyrë alternative, nëse Gjykata e Lartë vlerëson se kjo çështje nuk i përket juridiksionit gjyqësor penal, por ka natyrë administrative, në qëndrimin e këtij trupi gjykues, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk ka përcaktuar drejt kriteret ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e një parakushti të rëndësishëm procedural siç është ai i verifikimit të kompetencës lëndore. Në analizë të natyrës së çështjes, shkakut të saj ligjor, kërkimeve të palës ankuese, të parashtruara në kërkesën e depozituar dhe gjatë gjykimit të çështjes, si dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar, Gjykata konkludon se kjo mosmarrëveshje ka natyrë materiale administrative.

29. Në kuptim të përcaktimeve të mësipërme ligjore, Gjykata çmon se mosmarrëveshja objekt shqyrtimi gjyqësor ka lindur nga një akt administrativ individual, që është akti nr. 1938 prot., datë 08.09.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, me të cilin është refuzuar kërkesa e të paraburgosurit Dhionisios Alfred Beleri, për dhënie leje të veçantë. Pikërisht, ky është akti, që pala ankuese e kundërshton në gjykatë.

30. Gjykata vëren se vendimmarrja e Drejtorit të Përgjithshme të Burgjeve, e formalizuar në shkresën nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, është shprehje e vullnetit të një organi publik në ushtrim të funksionit të tij publik, kundrejt një subjekti, kërkuesit, të cilit i shuan një të drejtë, atë të përfitimit të “lejes së veçante”, sipas përcaktimit të nenit 73 të ligjit nr. 81/2020. Nga ana tjetër, edhe I EVP Durrës, edhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë organe publike në kuptim të pikës 6, të nenit 2, të ligjit nr. 49/2012, pasi ato: së pari, janë organe të pushtetit qendror, si organe në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe, së dyti, ligji i ka ngarkuar me kryerjen e funksioneve publike, e cila konsiston në kryerjen e veprimeve administrative, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 81/2020.

31. Gjykata vëren se edhe vetë Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në vendimmarrjen e saj, arrin në konkluzionin sipas të cilit: “9. (...) kërkesa objekt gjykimi që i paraqitet për gjykim, në thelb përbën një kërkesë me natyrë administrative-penale, sepse me anë të saj kërkohet investimi i Gjykatës për të zgjidhur konfliktin e një të paraburgosuri me institucionin e ekzekutimit të vendimit penal ku ai po qëndron për efekt të masës së sigurimit personale shtrënguese “Arrest në burg”, i cili nuk lejohet të ushtrojë një nga të drejtat e tij politike.”. Ndërkohë që në kundërshtim me të, në konkluzion të tij dhe në mënyrë të gabuar, ai trup gjykues, përcakton si gjykatë kompetente nga pikëpamja lëndore Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në vend të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

32. Ligji nr. 49/2012, në nenin 7, germa a), parashikon se: “Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik, “. Ndërkohë, neni 2, pika 6, parashikon se: “Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative (...)” Së fundi, në nenin 3, paragrafi 1, germa a), ligji nr. 44/2015, parashikon se: “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.”.

33. Në kuptim të dispozitave të cituara, ky trup gjykues arrin në konkluzionin se, zgjidhja e mosmarrëveshjes është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative, si një mosmarrëveshje që ka lindur nga akti administrativ individual, i nxjerrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik.

34. Përsa më lart, është një qëndrim i mbajtur edhe nga jurisprudenca e fundit e Gjykatës së Lartë, përmendin këtu vendimin nr. 00-2021-795, datë 10.05.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, apo vendimin nr. 00-2020-531, datë 12.10.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Pikërisht, në vendimin nr. 00-2020-531, datë 12.10.2020 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në shqyrtimin e kërkesës së palës kërkuese: L.ZH, me subjekt të interesuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier, me objekt gjykimi: “dhënie e lejes shpërblyese”, ndër të tjera ka arsyetuar: “15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se çështja në shqyrtim është e natyrës administrative dhe, për këtë shkak kompetente nga pikëpamja lëndore për gjykimin e saj është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë. 16. Siç me të drejtë ka konkluduar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, çështja është e natyrës administrative, pasi përmes kësaj padie kërkuesi kërkon detyrimin e një organi publik që të kryejë një veprim administrativ (...). Rezulton se kërkuesi kërkon pikërisht detyrimin e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier për t’i dhënë leje shpërblyese, pra për të kryer një veprim administrativ. (...) 19. Edhe pse në pamje të parë konstatohet se kemi të bëjmë me një të drejtë të personave të dënuar, e drejtë, e cila ushtrohet gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit penal, çështja nuk është e natyrës juridiko – penale, pasi vlerësimi që bëhet nga gjykata në këtë rast nuk lidhet me elementet penale të vendimit, por me sjelljen e të dënuarit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, vlerësim i cili kryhet fillimisht nga institucioni ku ai vuan dënimin Pra, në këtë rast, shqyrtimi gjyqësor ka të bëjë me ligjshmërinë dhe diskrecionin e veprimit administrativ të organit publik. (...)”.

35. Përsa i përket kompetencës tokësore, në bazë të parashikimeve të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 49/2012, sipas së cilës: “Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet. Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.”, kompetenca i takon Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal

36. Në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), konstaton ekzistencën e konfliktit të kompetencës (lëndore), pasi dy gjykata të ndryshme, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk pranojnë të gjykojnë ankimin e kërkuetit (të pandehurit të paraburgosur) Beleri për gjykimin e kërkesës penale nr. 71029 – 02531 – 11 – 2023/561 regjistri themeltar, datë regjistrimi 22.09.2023, me objekt: kundërshtimin e aktit nr. 1938 prot., datë 08.09.2023, njoftuar më datë 11.09.2023, pranimin e kërkesës për dhënie leje/autorizimi të veçantë.

37. Kodi i Procedurës Penale (në vijim KPP), në Kreun II, seksionin V, i titulluar “Mosmarrëveshjet për kompetencat”, nenet 89, 90 dhe 91 të tij, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve (midis gjykatave), mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen.

38. Neni 89, paragrafi i parë, i KPP parashikon se: “Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata, në të njëjtën kohë, marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person.”.

39. Neni 90 i këtij Kodi parashikon parashtrimin e mosmarrëveshjes në këtë mënyrë: “Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, të cilës i

bashkohet dokumentacioni i nevojshëm. 2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes, merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit. 3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje.”.

40. Neni 91 në vijim i KPP parashikon se: *“1. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Gjykata e Lartë me vendim. Gjykata merr të dhënat, aktet dhe dokumentet që i çmon të nevojshme. 2. Vendimi u komunikohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje, prokurorive përkatëse, të pandehurit dhe palëve private.”.*

41. Ndërsa paragrafi i parë i nenit 83 të KPP, parashikon se: *“1. Moskompetenca lëndore ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procesit.”.*

42. Lidhur me çështjen që i parashtrohet Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për zgjidhje, evidentohet se Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm që ka ngritur konfliktin, invokon pamundësinë e saj për shqyrtimin e çështjes – të dërguar prej Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – të motivuar kryesisht në mungesën e kompetencës lëndore të saj për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga i paraburgosuri, Z. Dhionisios Alfred Beleri dhe, në një aspekt më të gjerë – në alternativë – në mungesën e juridiksionit të mirëfilltë penal për trajtimin e kësaj lënde.

43. Lidhur me këtë aspekt të fundit, të mungesës së juridiksionit, gjykata parashtruese ka vënë në dyshim ekzistencën e juridiksionit penal – ushtrimin e tij prej gjykatave në konflikt, duke “aluduar” implikimin (në rastin konkret) e juridiksionit administrativ në funksion të zgjidhjes – trajtimit – të problematikës së evokuar në kërkesën e paraqitur prej kërkuarës, të pandehurit të paraburgosur Beleri. Në mbështetje të kësaj bindjeje, Gjykata (që ka ngritur konfliktin) ka evidentuar edhe qëndrime të Kolegjeve civile dhe administrative të Gjykatës së Lartë, të cilët, në lidhje me çështje të cilat kanë pasur për objekt kundërshtimin e vendimeve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, kanë përcaktuar si kompetente për shqyrtimin e tyre gjykatën administrative.

44. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjen rastin të theksojë se e vetmja “seli” e trajtimit të problematikës referuese në kërkesat dhe pretendimet (e të dënuarit) lidhur me ekzekutimin e vendimit të dënimit të tij, është Gjykata e vendit të ekzekutimit (dhe e mbikëqyrjes – gjatë ekzekutimit) të dënimit (të caktuar me vendimin penal të formës së prerë) e integruar nën juridiksionin penal, e cila aktivohet nën stimulimin e palëve (të dënuarit, por edhe të prokurorit), sikurse qartazi përcaktohet në nenin 470 të KPP, si dhe në nenin 80 të ligjit nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (në vijim ligji nr. 81/2020). Konkretisht, në nenin 470 të KPP”, të titulluar “Gjykata kompetente për ekzekutimin” parashikohet se: *“1. Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.”*, ndërsa në nenin 80 të ligjit nr. 81/2020, përcaktohet se gjykata kompetente për gjykimin e ankesave ndaj vendimmarrjes së institucionit të ekzekutimit të vendimit penal (apo dhe e vendimmarrjes së Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve) është gjykata e vendit të ekzekutimit të vendimit (dënimit) penal (në vazhdim gjykata e ekzekutimit dhe e mbikëqyrjes), e cila “operon” në përputhje me parashikimet e KPP. Ndër kërkesat që paraqiten në këtë fazë, janë edhe ato të parashikuara në nenin 73, të ligjit nr. 81/2020, që kanë të bëjnë me dhënien e lejeve të veçanta – për të dënuarit – në kompetencë të organit të ekzekutimit të dënimit (me burgim), të cilat i nënshtrohen (nën stimulimin e palëve) kontrollit juridiksional të institucionalizuar në gjykatën e ekzekutimit (dhe të mbikëqyrjes) së dënimit.

45. Kolegji konsideron se, kuadri ligjor i sipërcituar, i përvijuar në Kodin e Procedurës Penale, apo që referon shprehimisht në këtë Kod, identifikon qartë, pa asnjë ekuivok, titullaritetin e juridiksionin penal lidhur me shqyrtimin e këtyre kërkesave/ankesave – pjesë integrale e fazës së ekzekutimit të vendimit të dënimit.

46. Gjithashtu (një argument më tepër në funksion të mbështetjes së konkluzionit të sipërcituar), edhe parashikimi i paragrafit të katërt të nenit 471 të KPP, që imponon pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit me cilësinë e palës në gjykimin e kërkesave të kësaj faze terminale të procedimit penal – të ekzekutimit të vendimit (dënimit) penal para gjykatës së Ekzekutimit (dhe të mbikëqyrjes së këtij ekzekutimi) – përsa kohë që evokon se: “4. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi” – i cili – i raportuar edhe me përcaktimet e paragrafit të tretë, të nenit 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (që parashikon se: “3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.”), evidenton qartazi titullaritetin e aktivimit të juridiksionit penal (gjykatës së ekzekutimit të vendimit të dënimit) në trajtimin e problematikës së evidentuar gjatë kësaj periudhe dhe konkretisht të ankesave (kërkesave) të personave të dënuar ndaj vendimmarrjes së institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

47. Sakaq, përsa i përket kërkesave të paraqitura prej palëve gjatë fazave të tjera të procedimit penal – fazës fillestare të tij – të hetimeve paraprake – dhe të gjykimit të çështjes në themel – Kolegji Penal, duke iu referuar vullnetit të qartë të ligjvënësit, evidenton se rregulli klasik i përkatësisë së gjykimit të këtyre kërkesave identifikohet në “gjykatën që procedon (në kuadrin e fazës respektive të shtrirjes së procedimit) – që disponon materialisht aktet”, e cila, gjatë fazës së hetimeve paraprake, në konformitet me përcaktimet e nenit 278 të KPP, identifikohet në cilësinë e Gjykatës – gjyqtarit për hetimet paraprake, ndërsa gjatë gjykimit të çështjes në themel, me gjykatën e shkallës së parë dhe me gjykatën e shkallës së dytë.

48. Duke iu referuar konkretisht kërkesave të paraqitura prej subjekteve të proceduara nën masën e sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i KPP – të ashtuquajtur të paraburgosur – përsa kohë që i nënshtrohen kufizimit të lirisë për efekt të aplikimit të kësaj mase gjatë fazave të ndryshme të procedimit penal të regjistruar ndaj tyre, ku këta të fundit rezultojnë me cilësinë e të hetuarit (gjatë fazës së hetimeve paraprake) dhe të të pandehurit (gjatë gjykimit të çështjes – akuzës së kontestuar prej prokurorit – në themel) – kompetencës së trajtimit të tyre (përfshirë edhe kërkesën e paraqitur prej të pandehurit të paraburgosur Beleri – gjatë fazës së gjykimit të çështjes – akuzës – në ngarkim të tij – në themel – në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – me objekt “dhënien e lejes së posaçme” – kërkesë, e cila ishte refuzuar të trajtohej prej organit të ekzekutimit të dënimit) – Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë evokon kompetencën – rrënjëzimin e saj – pranë Gjykatës që procedon për gjykimin e procedimit kryesor – gjykimit të themelit të çështjes – akuzës së kontestuar prej Prokurorit apo – në rastin e gjykimit të kërkesave të fazës së hetimeve paraprake – përfshirë edhe gjykimin incidental për caktimin e masave të sigurimit personal – pranë gjyqtarit për hetimet paraprake – pra në thelb – pranë organit juridiksional që procedon në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë të posaçme – si të vetmet organe të legjitimuara – pikërisht prej titullaritetit të procedimit – disponimit material të akteve të këtij procedimi – për t’u prononcuar edhe për problematikën e karakterit subsidiar – në raport me gjykimin e procedimit kryesor apo të procedimit incidental – të identifikuar në kërkesën e sipërcituar.

49. Evokimi prej gjykatës (së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar) në konflikt – në justifikim të deklarimit të inkompetencës dhe atribuimit të saj gjykatës respektive – i kompetencës së gjykatës së ekzekutimit, të parashikuar në nenet 470, 471, të KPP, për të trajtuar kërkesën me objekt dhënien e lejes speciale për të pandehurin e paraburgosur, konsiderohet – minimalisht – prej këtij Kolegji në kushtet e inoportunitetit, përsa kohë që një gjykatë e tillë rezulton akoma e pakonstituuar – në pamundësi aktivimi – për shkak të inekzistencës së një vendimi (dënimi) të formës së prerë, objekt ekzekutimi, pasi gjykimi i çështjes verifikohet (akoma) në fazën e gjykimit në shkallë të parë.

50. Në terma të tjerë, në kushtet e paraburgimit të kërkuesit për efekt të zbatimit (ndaj tij) të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP, të caktuar në konformitet me përcaktimet e neneve 228, 229 të KPP, në funksion të garantimit të nevojave të sigurimit të procedimit kryesor, hetimit dhe gjykimit të akuzës, pra, në thelb, përsa kohë që vendimi nuk ka marrë formë të prerë, konsiderohet i patolerueshëm aksesit/implikimi në trajtimin e problematikave të karakterit subsidiar në raport me gjykimin e akuzës dhe me gjykimin e kërkesave (në këtë fazë) për revokim, zëvendësim apo shuarje të masës së sigurimit personal të caktuar (të sipërcituar) – në disponibilitet gjykimi të të njëjtës gjykatë që gjykon procedimin kryesor – i çdo lloj gjykate të ndryshme nga gjykata e investuar në gjykimin e procedimit kryesor.

51. Sa i përket përcaktimit se cila nga gjykatat e juridiksionit penal ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes, Kolegji çmon të drejtë parashtrimin dhe argumentimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Durrës. Kolegji çmon se kompetenca për shqyrtimin e çështjes i takon Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

52. Kështu, me të drejtë gjykata parashtruese e juridiksionit të përgjithshëm ka evidentuar parashikimin e nenit 278 të KPP, i cili parashikon: “1. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”. Një konkluzion të tillë gjykata parashtruese e ka mbështetur në interpretimin logjik dhe sistematik të nenit 278 të KPP në raport me nenet 13, 332 e vijues të KPP.

53. Me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka arsyetuar se gjendet në pamundësi juridike dhe praktike për shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi. Neni 73, paragrafi 2, i ligjit nr. 81/2020, parashikon se dhënia e “lejes së veçantë”, për të paraburgosurin jepet me pëlqimin paraprak të prokurorit. Kushtetuta në nenin 148, paragrafi 3, parashikon shprehimisht se: “Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.”. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nuk rezulton të ketë regjistruar asnjë procedim penal në ngarkim të kërkuesit Dhionisios Alfred Beleri, për këtë shkak ky subjekt – prokurori – është në pamundësi për të gjykuar nevojat e sigurimit, apo të mbajë një qëndrim për kërkesën e palës kërkuese.

54. Përcaktimi i sipërcituar që investon në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë fazës së hetimeve paraprake – në dhënien e “lejes së posaçme” për të arrestuarin nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg” – konsensusin substancial të Prokurorit, presupozon diskrecionin e këtij të fundit në cilësinë e titullarit të kësaj faze të procedimit penal (të hetimeve paraprake) për të vlerësuar impaktin e këtij veprimi – dhënies së lejes – në drejtim të ndikimit/paragjykimit/ të rezultateve të hetimit, të fshehtësisë së tyre. Thënë në terma të tjerë, aksesit i drejtuesit të institucionit të paraburgimit në vlerësimin e kushteve të aplikimit të kësaj leje është pothuajse inekzistent.

55. Në të njëjtat kushte Kolegji konsideron – në mbështetje të konkluzionit, sipas të cilit, gjatë gjykimit të çështjes penale është gjykata që procedon – që disponon materialisht aktet – kompetente për t’u prononcuar lidhur për çdo kërkesë të të pandehurit, përfshirë edhe kërkesat subsidiare, të lidhura me gjykimin e procedimit kryesor dhe të atij incidental (që bëjnë fjalë për revokim, zëvendësim dhe shuarje të masës së sigurimit personal të caktuar për të siguruar procedimin kryesor) – sikurse në rastin konkret kërkesa për leje të posaçme – aksesin e drejtuesit të institucionit të paraburgimit – në verifikimin (vlerësimin) e kushteve të aplikimit të kësaj leje – në kushtet e inekzistencës.

56. Përsa kohë që procedimi penal – gjykimi i çështjes – akuzës – ndaj të pandehurit të paraburgosur varet para Gjykatës së gjykimit të çështjes në themel, e cila disponon rast pas rasti krahas gjykimit të procedimit kryesor, edhe lidhur me masën e sigurimit personal

(të arrestit në burg) të caktuar ndaj tij në kuadrin e procedimit incidental të “implementuar” gjatë fazës së hetimeve paraprake – në funksion të sigurimit dhe garantimit të procedimit kryesor – verifikimin e vazhdimësisë (edhe në këtë fazë të procedimit) dhe të qëndrueshmërisë së nevojave të sigurimit të këtij procedimi – edhe gjykimi i kërkesave për “leje të posaçme” (gjatë kësaj faze) – vlerësimi – verifikimi – i kushteve të dhënies së tyre, përse kohë që implikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe “integritetin” e këtyre nevojave (të sigurimit) – nuk mund të realizohet përtej dhe duke anashkaluar – filtrin e kontrollit juridiksional – konsensusin (vullnetin) substancial të organit (të procedimit penal) – të gjykatës (që procedon) të gjykimit të çështjes në themel.

57. Përfundimisht, mbi bazën e arsytimit të mësipërm, konsiderohet prej këtij Kolegji, zgjidhja e konfliktit të kompetencës, midis gjykatës së juridiksionit të zakonshëm dhe asaj të juridiksionit special, në favor të dërgimit për kompetencë gjykimi të çështjes pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 91 të Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI:

1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes (konfliktit) së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, duke përcaktuar si Gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes, Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Vendimi t’u komunikohet gjykatave në mosmarrëveshje.

Tiranë, më 07.11.2023